



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 18.02.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër DPKI-OZQOMY-0266, për znj. Lebibe Haliti, Udhëheqëse në Sektorin për Punë Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pasi që nuk është konstatuar papajtueshmëri, përkatësisht konflikt i interesit në ushtrimin e funksionit publik sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe të njëjtit bëhen publik në faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për papajtueshmëri, përkatësisht konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik për znj. Lebibe Haliti, Udhëheqëse në Sektorin për Punë Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (në vijim: MINT), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit), Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), si dhe Rregulloren Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Rregullorja për Procedurat e Hetimit Administrativ).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një kërkesë nga parashtruesi (raportuesi) i rastit (në vijim: parashtruesi i kërkesës), me pretendimin për konflikt të interesit për znj. Lebibe Haliti, ku theksohet se (*citojmë nga kërkesa*): [...]...më lejoni të raportoj një rast për konflikt interesi nga Udhëheqësja e sektorit për çështje juridike dhe administrative në Inspektoratin e Tregut znj. Lebibe Haliti. Ju njoftojmë se Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut është agjenci ekzekutive pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e që ndër të tjera ka kompetencë të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi nga ana e operatorëve ekonomik - bizneseve. Duke qenë nën petkun e personit zyrtar znj. Haliti ka hapur biznes personal me emër "Zyrë Ligjore & Shërbime Biznesi Sh.P.K", ku edhe figuron si pronare, e ku në këtë biznes parashihet realizimi i aktiviteteve si në vijim: Aktivitete juridike,

Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim, Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t., Aktivitetet e shoqatave dhe organizatave ekonomike, punëdhënësve si dhe Aktivitetet e tjera p.k.t.[...].

Tutje në kërkesën e parashtruesit të kërkesës theksohet se: “[...],... gjatë periudhës 21/06/2021 deri me datë 22/06/2023 znj. Haliti ka ushtruar detyrën e Kryeinspektores në Inspektoratin e Tregut pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e pas kësaj pozite e njëjta ka vazhduar të Udhëheqë me Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në vijim: ARBK) nga data 23/06/2023 deri me datë 29/07/2025. [...], ... në rastin konkret me qëllim të përfitimit personal dhe duke dëmtuar interesin publik, znj. Lebibe Haliti vazhdon të punoj në biznesin e saj dhe në të njëjtën kohë nuk paraqitet në vendin e saj të punës duke ezauruar pushimin mjekësor dhe atë vjetor, e që duke përdorur pozitën e vet po avancon interesat private, e që ky veprim i saj është në kundërshtim edhe me paragrafin 9 të nenit 5 të të njëjtit ligj, [...]. Pra, znj. Haliti si pronare e biznesi “Zyrë Ligjore & Shërbime Biznesi Sh.P.K” ofron shërbime për operatorë ekonomik - Bizneset që ajo gjatë periudhës sa ka qenë duke ushtruar pozitën e Kryeinspektores së Tregut, të njëjtat i ka mbikëqyrur, e që pastaj ka udhëhequr drejtuar ARBK-në, e që ky angazhim i saj si pronare e një biznesi që aktivitet kryesor ka ofrimin e shërbime për bizneset vjen në periudhën kohore në më pak se dy vjet që nga largimi i saj nga pozitat udhëheqëse në institucionet mbikëqyrëse të bizneseve. Pasi që znj. Haliti mbanë pozitë Udhëheqëse në sektorin për çështje juridike dhe administrative në Inspektoratin e Tregut, vlerësojmë se puna e saj në biznesin e saj ofron trajtim favorizues ose informacion konfidencial gjatë kontraktimit të shërbimeve për përfitime personale dhe se përmes këtyre veprimeve e cenon rëndë interesin publik - interesin e institucionit publik, cenon sigurinë e informacioneve të Inspektoratit të Tregut i cili informacion është i kufizuar për palët e treta. [...]”.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, fillimisht është realizuar një takim me parashtruesen e kërkesës, ku janë shtjelluar e sqaruar pretendimet e ngritura, veçanërisht ato të cilat hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht kufizimeve, ndalesave apo papajtueshmërive në ushtrimin e funksionit publik në vështirim dhe kuptim të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë , parashtruesi i kërkesës ka dërguar edhe informacionin plotësues (citojmë pjesë relevante të këtij informacioni): “[...].znj. Haliti si udhëheqëse e sektorit përkatës në Inspektoratin e Tregut ka për obligim që ndihmën juridike dhe administrative ta ofroj për inspektorët lidhur me aktivitetet e tyre inspektuese në terren ndaj bizneseve dhe për Kryeinspektorin sipas nevojës, ku ka shumë informacione të cilat janë të kufizuara për palët e treta në këtë rast bizneset. Ndërsa, në këto momente znj. Haliti është duke ofruar ndihmë juridike dhe shërbime për biznese (përmes biznesit të saj), duke cenuar rëndë pozitën që ka në Inspektoratin e Tregut ku ndër të tjera mund të keqpërdorë informacionet e brendshme të Inspektoratit të Tregut duke i vënë në dispozicion të bizneseve. [...]. Përgjatë periudhës sa znj. Lebibe Haliti nuk është duke u paraqitur në vendin e saj të punës, sipas informacioneve që ne posedojmë e njëjta është duke punuar në Biznesin e saj personal me emër “Zyrë Ligjore & Shërbime Biznesi Sh.P.K”, i cili biznes është regjistruar në ARBK me datë 16.09.2025. [...]”.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ka dërguar shkresë zyrtare DPKI-3200/25,

znj. Lebibe Haliti, duke e njoftuar atë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në funksion të sqarimit të mëtuftjeshëm të këtij rasti, është mbajtur një takim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit me znj. Lebibe Haliti, ku janë diskutuar dhe shtjelluar në hollësi pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës. Në takim, znj. Haliti ka sqaruar dhe paraqitur qëndrimet e saj lidhur me rastin në fjalë, duke ofruar informacion konkret lidhur me angazhimin e saj në biznesin privat “Zyrë Ligjore & Shërbime Biznesi” Sh.P.K, dhe me këtë rast ajo ka mohuar si të pa bazuara pretendimet e ngritura për konflikt të interesit nga parashtruesja e kërkesës.

Në mbështetje të sqarimeve dhe qëndrimeve të mbajtura në takim, znj. Lebibe Haliti ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit një deklaratë me shkrim, ku ndër të tjera ka theksuar se (citojmë pjesë relevante të deklaratës në fjalë): “[...] Që nga data 18.07.2025 nuk kam qenë zyrtarisht dhe as faktikisht e pranishme në MINT dhe nuk kam ushtruar asnjë funksion publik, pasi kam qenë fillimisht në pushim vjetor, më pas në pushim mjekësor dhe në pushim pa pagesë, [...]. Më pas, marrëdhënia ime e punës është ndërprerë me Vendim të Komisionit Disiplinor të MINT të datës 27.11.2025 (me arsyetim të mos paraqitjes në punë edhe pse kam paraqitur dëshmitë mjekësore), i cili Vendim aktualisht është objekt ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMShCK)”.

Tutje në deklaratën e saj, sa i përket hapjes së biznesit privat, znj. Haliti ka shtuar se: “Biznesi është regjistruar pas paraqitjes së kërkesës për pushim pa pagesë, në kohën kur nuk kam pasur status të zyrtares publike aktive dhe rrjedhimisht, nuk kam pasur asnjë kompetencë publike, ndikim institucional apo mundësi reale për përfitim nga pozita shtetërore. Biznesi është regjistruar përmes platformës shtetërore e-Kosova në mënyrë të rregullt dhe ligjore dhe nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë raport funksional, mbikëqyrës apo kontraktual me MINT apo me ndonjë institucion tjetër publik. Në këto rrethana, mungojnë plotësisht elementet thelbësore të konfliktit të interesit: funksioni aktiv, ndikimi institucional dhe përfitimi material”.

Ndërsa, lidhur me përdorimin e emailit zyrtar në biznesin privat, znj. Haliti ka deklaruar se: “Emaili zyrtar ka qenë i ruajtur në profilin tim në platformën e-Kosova për arsye se gjatë hapjes së profilit në e-Kosova, kam vendosur e-mailin zyrtar dhe për faktin që aplikimi për hapje të biznesit është realizuar përmes platformës e-Kosova, njoftimi për përfundimin e procesit të regjistrimit të biznesit, është përcjell edhe në e-maili zyrtar. Në dokumentacion dhe në regjistrin zyrtar të ARBK-së që është i qasshëm për publikun shihet që është vendosur e-maili privat. E-maili nuk figuron në dokumentet publike të biznesit, nuk figuron në certifikatën e regjistrimit në ARBK, nuk është i ekspozuar për publikun dhe nuk prodhon asnjë pasojë juridike apo përfitim. Duke qenë se në momentin e regjistrimit të biznesit kam qenë në pushim pa pagesë, gjatë të cilit pezullohen të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe duke qenë se nuk kam ushtruar funksion publik aktiv, nuk kam pasur qasje institucionale dhe nuk kam përfituar asnjë avantazh, pretendimi për konflikt interesi është juridikisht i pabazuar dhe faktikisht i pavërtetë”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka shqyrtuar, analizuar dhe administruar provat relevante që lidhen me vërtetimin e fakteve/pretendimeve për konflikt të interesit, përkatësisht papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, informacionin nga znj. Lebibe Haliti, si dhe informacion tjetër relevant të siguruar sipas detyrës

zyrtare, të gjitha këto në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Sipas emailit të datës 27.07.2025, dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore - DBNJ/MINT, tek të gjithë ushtruesit aktual të detyrave, theksohet se, "*Vendimet për caktimin e zyrtarëve si zëvendësues në pozita të lira drejtuese bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura konsiderohen të shfuqizuara tridhjetë (30) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Obligohen institucionet që brenda këtij afati të përshtatin këto vendime në përputhje me nenin 35 të ligjit bazik.*", prandaj znj. Lebibe Haliti e cila nga data 23.06.2023, deri më datë 29.07.2025, ka qenë ushtruese e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (në vijim: ARBK), nga data 30.07.2025 e tutje, është kthyer në pozitën e saj të mëparshme si Udhëheqëse në Sektorin për Punë Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut - MINT;

Me datë 15.09.2025, znj. Lebibe Haliti ka regjistruar biznesin "*Zyrë Ligjore & Shërbime Biznesi*" sh.p.k., ku si pronare/aksionare e vetme mbanë funksionin e drejtorit menaxhues dhe përfaqësueses së autorizuar, ndërsa si aktivitete të këtij biznesi janë paraqitur: aktivitete juridike, aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim, aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t., aktivitetet e shoqatave dhe organizatave ekonomike, punëdhënësve, si dhe aktivitete tjera p.k.t.;

Në aplikimin, përkatësisht fletëparaqitjen për regjistrim fillestar të biznesit në fjalë "*Zyrë Ligjore & Shërbime Biznesi*" sh.p.k, në faqen e fundit (fq.5) të aplikacionit figuron e-maili zyrtar i znj. Lebibe Haliti.

Në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstatoi si në dispozitiv të këtij vendimi se, në rastin konkret nuk ekziston papajtueshmëri, përkatësisht konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik për znj. Lebibe Haliti, për arsyet si në vijim:

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përcaktuar parime, të drejta e detyrime, kufizime, ndalesa, papajtueshmëri, përkatësisht situata të konfliktit të interesit për *persona zyrtarë, zyrtarë publik dhe zyrtarë të lartë*, të cilat gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre publike dhe varësisht nga statusi i tyre, zbatohen/aplikohen dispozita përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Kësisoj, funksioni/pozita e znj. Lebibe Haliti si Udhëheqëse në Sektorin për Punë Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut në MINT, nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, lidhur me nenin 4, të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave [*Zyrtarët e lartë*].

Duke qenë se pozita Udhëheqëse në Sektorin për Punë Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut, nuk bën pjesë në kategorinë e *zyrtarëve të lartë* në kuptim të Ligjit përkatës për Deklarimin e Pasurisë, atëherë kufizimet, ndalesat dhe/ose papajtueshmëritë për zyrtarë të lartë në ushtrimin e funksionit publik, nuk vlejnë e rrjedhimisht as nuk zbatohen/aplikohen në rastin konkret.

Prandaj, për arsyet e sipërcekura, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konstaton se mbajtja e njëkohshme e funksioneve drejtuese në biznesin e sipërcekur nga znj. Lebibe Haliti, krahas ushtrimit të funksionit publik si Udhëheqëse në Sektorin për Punë Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut, nuk përbën papajtueshmëri, përkatësisht konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Megjithatë, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit përveç kufizimeve, ndalesave dhe papajtueshmërive në ushtrimin e funksionit publik të aplikueshme për zyrtarët e lartë, dispozita të caktuara të këtij ligji, kanë përcaktuar ndalesa të cilat në situata dhe rrethana të caktuara (veçanërisht kur bëhet fjalë për angazhime në biznese/sferë private) mund të aplikohen për zyrtarët/nëpunësit publik, pavarësisht kategorisë/statusit të tyre publik.

Kësisoj, dispozitat e nenit 11 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kanë përcaktuar se:

“1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse:

1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private;

1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë;

1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit; [...]”.

Pra, me dispozitat e sipërcituara, zyrtarit/es mund t'i ndalohet që të kryejë punë të tjera, nëse vlerësohet nga punëdhënësi se ai/ajo: *mund të keqpërdorë informacionin zyrtar, punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë, dhe angazhimet e tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit.*

Prandaj, në kuptim dhe vështrim të asaj që u tha më lartë, zyrtari/nëpunësi publik është i obliguar që paraprakisht ta njoftojë punëdhënësin/udhëheqësin e tij për çdo angazhim në punë sekondare, në mënyrë që të vlerësohet paraprakisht nëse me rastin e një angazhimi të tillë, mund të bihet ndesh me dispozitat e sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në rastin konkret, duke marr parasysh fushë-veprimtarinë specifike të institucionit (Ministrisë) në fjalë, e veçanërisht të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut në kuadër të MINT (mbikëqyrja e bizneseve/sectorit privat), vlerësimi nga punëdhënësi lidhur me përshtatshmërinë dhe pajtueshmërinë e çdo angazhimi sekondar të zyrtarëve në biznese/sferë private, konform dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, bëhet edhe më i domosdoshëm.

Gjithashtu, me dispozitën e nenit 20, paragrafi 3, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përcaktuar se: *“Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës”.* Në këtë kontekst, çdo angazhim sekondar i zyrtarëve në punë tjera, veçanërisht në biznese/sferë private, duhet të jetë në pajtim edhe me rregullativën e brendshme ligjore të institucionit punëdhënës në fjalë, veçmas normativës që ka të bëjë me konfliktin e interesit apo papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërsa, sa i përket situatave të konfliktit *rast për rast* të interesit, paragrafi 1 i nenit 17, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje".

Prandaj, gjatë ushtrimit të funksionit publik çdo zyrtar duhet të ketë parasysh se, kurdo dhe në secilin rast kur paraqitet ndonjë situatë e konfliktit *rast për rast* të interesit, zyrtari duhet të deklaroj konfliktin e interesit dhe të tërhiqet nga çfarëdo vendimmarrje në ato raste, në përputhje me dispozitën e sipërcituar të nenit 17, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Së fundmi, sa i përket çështjes së ngritur nga parashtruesja e kërkesës se në aplikacionin për regjistrimin e biznesit nga znj. Lebibe Haliti, figuron e-maili zyrtar i saj, por edhe çështjeve dhe /ose aspekteve tjera ligjore procedurale lidhur me zyrtaren në fjalë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk është lëshuar në trajtimin e tyre dhe rrjedhimisht as nuk e paragjykon epilogun e tyre, pasi që të njëjtat janë jashtë sferës së konfliktit të interesit, përkatësisht jashtë kompetencës dhe mandatit të Agjencisë.

II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [*Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit*], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *"Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë"*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *"Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative"*.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: *Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- znj. Lebibe Haliti dhe parashtrueses së kërkesës
- Sekretarit të Përgjithshëm të MINT
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtarit përgjegjës (bartësit të lëndës)


YIL BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit